

AGJENCI AKOMBETARE

E MJEDISIT
NR 5736 PROT
DATE 10/04 2026

Date 10/ 04/ 2026

NJOFTIM

Drejtuar : Agjencise Kombetare te Mjedisit

Lenda: Kerkese per zhvillimin e procedures se degjeses me publikun per ndryshimin e kushteve te lejes mjedisore te tipit B me PN-1872-07-2023

Shoqeria "POENIA-GROUP" Sh.p.k ne cilesine e mbajtesit te lejes mjedisore ekzistuese te tipit B me PN-1872-07-2023 njofton Agjencine Kombetare te Mjedisit per zhvillimin e procedures se informimit te publikut per aplikimin per ndryshimin e kushteve te lejes se mjedisit te tipit B per instalimin:

Magazinim, ruajtje dhe transferim i mbetjeve te rrezikshme dhe jo te rrezikshme me vendndodhje Pasuria numer 983, Zona kadastrale 3965, Metalurgjiku, Elbasan.

Ky njoftim hartohet Referuar VKM 419, date 25.06.2014 , Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja" te ndryshuar, kreu VI "Informimi dhe pjesemarrja e publikut per aplikimin per leje mjedisi te tipit A dhe B", bashkangjitur gjeni dokumentacionin e kerkuar, sipas pikes 2 te ketij kreu:

- a) Informacion nëse kërkesa do të jetë për "Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B" apo "**Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B me PN-1872-07-20236**".
- b) Të dhënat e ekstraktit të QKR-së;
- c) Adresën e vendndodhjes së instalimit;
- d) Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim;
- e) Një përshkrim të elementeve të listuara në formularin informues;
- f) Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkuftar, kur kërkohet procedura e VNM-së;
- g) Konsultimet ndërkuftare, kur kërkohet sipas legjisllacionit në fuqi;
- h) Autoritetin vendimmarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen;
- i) Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit

- a. Kërkesa për ndryshimin e kushteve të lejes mjedisore të tipit B të instalimit “Magazinin, ruajtje dhe transferim i mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme” është për aplikim për ndryshim (shtimin e kodeve të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme) të kushteve të lejes së mjedisit të tipi B me PN-1872-07-2023, në instalimet ekzistuese sipas Shtojcës 1, të Ligjit Nr. 52/2020, datë 30.04.2020 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” të ndryshuar”,

Menaxhimi i mbetjeve

- ID 5.5 Magazinim i hekurishteve/skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme
- ID 5.7 Magazinim, trajtim, riparim ose rinovim i mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike (WEEE)
- ID 5.8 Magazinim, rikuperim i hekurishteve/skrapeve të metalit ose çmontimi i mbetjeve nga motorët e makinave
- ID 5.10 a Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme që nuk përmendet më lart
- ID 5.10 b Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart

b. TE DHENAT E EKSTRAKTIT TE QKB-SE




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
DENDRA KOMBËTARE E DIZNETIT

EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRÇJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIB)	M32523203B
2. Data e Regjistrimit	23/01/2023
3. Emri i Subjektit	POENLA-GROUP
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	09/01/2023
6. Kohëzgjatja	Nga: 09/01/2023
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Ehësan Ehësan, Metahurgjiho Ehësan, Pavarura numer 983,Zona kadastrale 3965 3001
8. Kapitali	200,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00
9. Objekti i aktivitetit	Mbledhje, grumbullim, transportim, perpunim, eksportim i vajrave lubrifikante industrial dhe mjeteve motorrike. Mbledhje, grumbullim, transportim, perpunim, eksportim i aksit dhe plastikës. Grumbullim, transportim, perpunim, riciklim materialeve dhe mbetjeve të ndryshme, importimi dhe eksportimi i tyre. Mbledhje, grumbullim, perpunim, transportim i vajrave të djegur ujqumjore. Transport për vete dhe për të tjerë të mallrave të ndryshëm. Import-eksport, tregim me shumicë të lendeve të para ,makineri, produkte të fusthes se industrise mekanike, elektrike ndërtesa kimike, ushqimore etj. Investime në fushën e ndërtimit të publikë, shërbime civile, shërbime mund të kryejë çdo transakcion në lidhje me pasuritë e huajshme si dhe çdo aktivitet tjetër, financiar, dënie-marrje me qera, të vendosë pengje dhe barre hipotekore. Te bleje ne


c. ADRESA E VENDNDODHJES SE INSTALIMIT

Emri i instalimit/impianit ¹	Magazinin, ruajtje dhe transferim i mbetjeve te rrezikshme dhe jo te rrezikshme																																				
Adresa ku ndodhet apo do të ngrihet instalimi/impianiti	Pasuria numer 983, Zona kadastrale 3965, Metalurgjiku, Elbasan																																				
<p>Koordinatat e vendit sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4</p> 	<table border="1" data-bbox="885 655 1201 882"> <thead> <tr> <th colspan="3">Koordinatat e pronës ku zhvillohet aktiviteti</th> </tr> <tr> <th>Nr</th> <th>X</th> <th>Y</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>4551204.89</td> <td>4417834.04</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>4551215.14</td> <td>4417855.72</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>4551185.86</td> <td>4417869.24</td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>4551175.33</td> <td>4417847.00</td> </tr> </tbody> </table> <table border="1" data-bbox="885 913 1201 1102"> <thead> <tr> <th colspan="3">Koordinatat e objektit</th> </tr> <tr> <th>Nr</th> <th>X</th> <th>Y</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>4551193.45</td> <td>4417842.73</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>4551203.15</td> <td>4417838.64</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>4551210.80</td> <td>4417855.39</td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>4551201.52</td> <td>4417859.48</td> </tr> </tbody> </table>	Koordinatat e pronës ku zhvillohet aktiviteti			Nr	X	Y	1	4551204.89	4417834.04	2	4551215.14	4417855.72	3	4551185.86	4417869.24	4	4551175.33	4417847.00	Koordinatat e objektit			Nr	X	Y	1	4551193.45	4417842.73	2	4551203.15	4417838.64	3	4551210.80	4417855.39	4	4551201.52	4417859.48
Koordinatat e pronës ku zhvillohet aktiviteti																																					
Nr	X	Y																																			
1	4551204.89	4417834.04																																			
2	4551215.14	4417855.72																																			
3	4551185.86	4417869.24																																			
4	4551175.33	4417847.00																																			
Koordinatat e objektit																																					
Nr	X	Y																																			
1	4551193.45	4417842.73																																			
2	4551203.15	4417838.64																																			
3	4551210.80	4417855.39																																			
4	4551201.52	4417859.48																																			
<p>Kategoritë e aktiviteteve/veprimtarive industriale të cilat duhet të kërkojnë leje mjedisit²</p>	<p>Menaxhimi i mbetjeve</p> <p>ID 5.5 Magazinin i hekurishteve/skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme</p> <p>ID 5.7. Magazinin, trajtim, riparim ose rinovim i mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike (WEEE), Kapaciteti kufi per lejet e tipit B</p> <p>I.D 5.8 Magazinin, rikuperim i hekurishteve/ skrapeve të metalit ose çmontim i mbetjeve nga motorët e makinave, Kapaciteti kufi per lejet e tipit</p>																																				

¹ Përshkruaj titullin sipas kullonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Për Lejet e mjedisit

² Shkruani kodet e specifikuar në kullonën 2 (e emërtuar ID) dhe aktivitetet e specifikuar në kullonën 3 (Veprimtaria) të përcaktuara në Shtojcën 1 të Ligjit për Lejet e Mjedisit. Nëse instalimi përfshin disa aktivitete të lidhura me IPPC, është e nevojshme për të shënuar secilin prej tyre me një kod. Kodet duhet të jenë të ndara qartë.

	<p>B</p> <p>ID 5.10 a Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme që nuk përmendet më lart, Kapaciteti kufi për lejet e tipit B dhe ID 5.10 b Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart, Kapaciteti kufi për lejet e tipit B</p>
<p>Kapaciteti i projektuar</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Magazinimi i mbetjeve të metaleve ferrose • Magazinimi i mbetjeve të metaleve joferrose • Magazinimi i mbetjeve elektrike dhe elektronike (WEEE) • Magazinimi i mbetjeve të baterive • Magazinimi i mbetjeve të vajrave lubrifikante • Magazinimi i mbetjeve nga demolimi i automjeteve • Magazinimi i mbetjeve të rrezikshme të llojeve të ndryshme • Magazinimi i mbetjeve jo të rrezikshme të llojeve të ndryshme



d. PERSHKRIMI I VEPRIMTARISE QE PARASHIKOHET TE ZHVILLOHET

AKTIVITETI: Magazinim, ruajtje dhe transferim i mbetjeve te rrezikshme dhe jo te rrezikshme

Adresa: Pasuria numer 983, Zona kadastrale 3965, Metalurgjiku, Elbasan

Subjekti: "POENIA-GROUP" Sh.p.k

Administrator: Z. Elton Shehu

- **Hyrje**

Profili i shoqërisë "POENIA-GROUP" Sh.p.k

Instalimet per magazinim, ruajtje dhe transferim mbetjeve te rrezikshme dhe jo te rrezikshme të shoqërisë "POENIA-GROUP" shpk jane ekzistuese dhe te pozicionuara ne Pasuria numer 983, Zona kadastrale 3965, Metalurgjiku, Elbasan. Kjo shoqëri është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, për aktivitetin ne fushen e Mbledhje,grumbullim,transportim,perpunim,eksportim i vajrave lubrifikante industrial dhe mjeteve motorrike. Mbledhje,grumbullim,transportim,perpunim,eksportim i skrapit dhe plastikes. Grumbullim,transportim,perpunim,riciklim materialesh dhe mbetjesh te ndryshme,importimi dhe eksportimi i tyre. Mbledhje,grumbullim,perpunim,transportim i vajrave te djegur ushqimore, me NR NIPT: M32523203B.

Prona ku zhvillohet veprimtaria ne fushen e menaxhimit te integruar te mbetjeve te rrezikshme dhe jo te rrezikshme, eshte marre me qira nga shoqeria. Objekti ku veprimtaria e ruajtjes/magazinimit te mbetjeve te rrezikshme dhe jo te rrezikshme eshte e tipit kapanon me konstrukcion beton/arme me mbulese konstrukcion metalik dhe sheshi i transferimit te mbetjeve eshte i shtruar pjeserisht me cakull dhe pjeserisht me beton ku kryhen proceset e magazinimit te mbetjeve jo te rrezikshme. Brenda siperfaqes se menaxhimit te mbetjeve eshte ndertuar infrastruktura rrugore e cila komunikon me pronen dhe objektet e tjera ne pronesi te shoqerise. Prona disponon hapesirat e nevojshme per zhvillimin e proceseve, levizjen e mjeteve te transportit dhe mjeteve teknologjike qe kryejne operacionet ne fushen e menaxhimit te integruar te mbetjeve. Pergjate gjithë gjatesise se siperfaqes ku zhvillohen proceset e menaxhimit te mbetjeve eshte ndertuar rrjeti i drenazhimit te ujerave siperfaqesore, te cilet dergohen ne rrjetin e kanalizimeve te zones.

**Siperfaqja totale ku zhvillohet veprimtaria per truall 784 m²
menaxhimin e mbetjeve te rrezikshme dhe jo te ndertese 200 m²
rrezikshme**

Informacion mbi kompanine "POENIA-GROUP" sh.p.k

Shoqeria "POENIA-GROUP" sh.p.k eshte nje subjekt i regjistruar i pajisur me leje mjedisore te tipit B me PN-1872-07-2023, e cila zhvillon aktivitetin e saj ekonomik ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, ku objekt te veprimtarise se saj ka grumbullim, transportim, ruajtje, magazinim, transferim dhe eksportim te mbetjeve te rrezikshme dhe jo te rrezikshme te llojeve te ndryshme (nga perpunimi i ushqimeve, ambalazheve, tekstileve, mbetjet ferrose dhe joferrose, skrapeve/hekurishteve, vajrave lubrifikante, vjarave ushqimore, baterive, elektrike dhe elektronike, bojerave, leter, karton, qelq, plastike, metale te ndryshme, mbetje te drurit, mbetje nga cmontimi i makinave, etj). Duke pare te gjithë fushen e veprimtarise ku operon, shoqeria kerkon te kryej menaxhimin e integruar te mbetjeve ne fushen e "Magazinim, ruajtje dhe transferim i mbetjeve te rrezikshme dhe jo te rrezikshme te llojeve te ndryshme". Qellimi i firmes ka qene dhe mbetet permbushja e kerkesave te cilesise dhe per kete kompania ndjek dhe zbaton me rigorozitet menaxhimin e cilesise ne te gjitha hallkat e saj.

Gjate kesaj periu dhe te ushtrimit te veprimtarise per cilen shoqeria "POENIA-GROUP" sh.p.k eshte mbajtese e lejes mjedisore te tipit B, ka zbatuar me korrektesi detyrimet dhe kerkesat mjedisore te lejes se mjedisit dhe legjislacionit ne fuqi per menaxhimin e integruar te mbetjeve. Duke qene se rrymat e mbetjeve te gjeneruara nga sektore te ndryshem industriale jane gjithmone ne rritje dhe legjislacioni ne fuqi kerkon nje menaxhim te integruar te tyre nga subjekte te licencuara. Duke qene subjekt i licencuar dhe me pervoje ne fushen e menaxhimit

te mbetjeve te rrezikshme dhe jo te rrezikshme, shoqeria POENIA-GROUP, ka nisur procedurat per shtimin e kodeve te mbetjeve ne instalimet e lejes mjedisore ekzistuese.

Per kete qellim, subjekti **"POENIA-GROUP" sh.p.k** pasi eshte pajisur me shkresen per ndryshim te kushteve te lejes mjedisore te tipit B nga Agjencia Kombetare e Mjedisit, si dhe referuar Shtojces 1 te Ligjit nr. 52/2020 Per disa ndryshime ne ligjin nr. 10 448, date 14.7.2011 "Per lejet e mjedisit" te ndryshuar dhe VKM nr. 419, date 25.6.2014 "Per miratimin e kerkesave te posaçme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A dhe B, per transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit, si dhe rregullave te hollësishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja" te ndryshuar, Kreu III ka plotësuar dokumentacionin e kerkuar per aplikim per ndryshimin e kushteve te lejes mjedisore te tipit B me PN-1872-07-2023 per aktivitetin Magazinim, ruajtje dhe transferim i mbetjeve te rrezikshme dhe jo te rrezikshme, me vendndodhje Pasuria numer 983, Zona kadastrale 3965, Metalurgjiku, Elbasan. Subjekti disponon staf dhe pajisje profesionale per zhvillimin e ketij aktiviteti dhe shtimin e kapacitetit per kodet e reja.

Vendosja e ketyre instalimeve ne kete zone eshte e pershtatshme per zhvillimin e ketij aktiviteti pasi eshte ne distance te konsiderueshme nga zonat e banuara, objektet apo veprat hidroenergetike, etj, objekti ndodhet brenda zones industriale te Bashkise Elbasan, e njohur si Ish Kombinati Metalurgjik Elbasan, ne zonen ne studim jane perqendruar disa aktivitete, kryesisht ne fushen e perpunimit te skrapeve/metaleve, shkrirjes ne fonderi, riciklimit te aluminit, plumbit, riciklimit te gomave, shkrirjes se produkteve minerare, menaxhimit te mbetjeve, rafineri naftes, prodhimit te betonit dhe asfalto betonit, fraksionimit te inerteve, prodhimit te plastikes, etj.

Qëllimi i këtij aktiviteti është menaxhimi i integruar i mbetjeve te metaleve ferrose dhe joferrose qe gjenerohen nga sektoret e ndryshme industriale, menazhimit te mbetjeve elektrike dhe elektronike qe gjenerohen nga industria/institucionet/sektori familjar, menazhimit te mbetjeve te baterive, si dhe menazhimit te mbetjeve te rrezikshme dhe jo te rrezikshme llojeve te ndryshme (vajrave, bojerave,, etj), duke bere te mundur ruajtjen/magazinimin e perkohshem te tyre dhe me pas eksportimin e tyre jashte territorit te Shqiperise me qellim rikuperimin dhe riciklimin e mbetjeve.

Rrymat e mbetjeve per te cilat shoqeria kerkon qe te shtohen ne lejen mjedisore ekzistuese, jane nga sektoret industriale per nxjerrjen e mineraleve metalore dhe jo metalore, mbetjeve nga perpunimi kafsheve dhe bimeve, llumrave te ujerave te ndotura nga bujqesia, industria e letres, tekstileve, industria e perpunimit te celiqeve, aluminit dhe plumbi, llumra nga depozitat e naftes, mbetje te perziera urbane dhe shtepiake, etj.

Aktiviteti është ekzistues dhe zhvillohet në një ambient të përshtatshëm për këtë aktivitet duke mos krijuar kështu dëm apo efekte negative të ndryshme në mjedisin përreth.

- **Instalimet për menaxhimin e integruar të mbetjeve janë:**
 1. Magazinimi i mbetjeve të metaleve ferrose
 2. Magazinimi i mbetjeve të metaleve joferrose
 3. Magazinimi i mbetjeve nga cmontimi i makinave (automjeteve)
 4. Magazinimi i mbetjeve elektrike dhe elektronike (WEEE)
 5. Magazinimi i mbetjeve të baterive
 6. Magazinimi i mbetjeve të vajrave të përdorura
 7. Magazinimi i mbetjeve të rrezikshme të lojeve të ndryshme
 8. Magazinimi i mbetjeve jo të rrezikshme të llojeve të ndryshme
- **Te përgjithshme**

Operatori POENIA-GROUP Sh.p.k kryesisht operon në fushën e grumbullimit, transportimit, ruajtjes, magazinimit, transferimit dhe eksportimit të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme të llojeve të ndryshme, ndaj shoqërive me të cilat ky operator ka nënshkruar kontratat përkatëse të shërbimit. Si një shoqëri sensitive me çështjet mjedisore aktuale dhe me çështjet e menaxhimit të integruar të mbetjeve, operatori POENIA-GROUP Sh.p.k ka marrë të gjitha masat përkatëse për shtimin e kodeve të reja në lejen dhe licencën ekzistuese që disponon, me qëllim mbrojtjen e mjedisit, shëndetit të punonjësve, parandalimin e minimizimin e mbetjeve ose pakesimin e ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve dhe përmirësimin e efikasitetit të përdorimit të tyre.

Me besimin e cilesia, shërbimi për klientet dhe teknologjia e avancuar do të çojnë në përmirësim të vazhdueshëm në të gjitha zonat operacionale të veprimtarisë, duke ndermarrë programe të menaxhimit të cilësive dhe mjedisit që inkurajojnë bashkëpunim dhe komunikim, vendimarrje racionale, përmirësojnë efikasitetin operacionale, identifikojnë dhe menaxhojnë riskun.

Gjatë zhvillimit të veprimtarisë shoqëria:

- Identifikon, etiketon, ambalazhon dhe ripërdor mbetjet e rrezikshme dhe jo të rrezikshme të gjeneruara nga sektorët e ndryshëm, duke rritur efikasitetin e përdorimit të mbetjeve dhe duke reduktuar impaktet negative në mjedis
- Integron në vendimarrjet e subjektit, duke patur konsideratën e çështjet dhe impaktet mjedisore
- Ndergjegjëson në mënyrë të vazhdueshme punonjësit e Shoqërisë dhe kontraktoret dhe inkurajon për të punuar në mënyrë miqësore me mjedisin.

- Trajnon, edukon dhe informon punonjesit rreth ceshtjeve mjedisore qe do te ndikojne ne punen e tyre.
- Gjate zhvillimit te operacioneve te menaxhimit te mbetjeve ku zhvillohet veprimtaria dhe ne objektet e tjera te cilave i ofrohen sherbimet e menaxhimit te mbetjeve
- Shmanget perdorimi i panevojshem i materialeve si dhe ndermerren te gjitha hapat e nevojshme per te mbrojtur shendetin dhe mjedisin ne rast se materiale te tilla do te perdoren ose depozitohen ne zonen ku zhvillohet veprimtaria.
- Kur kerkohet nga legjislacioni, ose kur egzistojne rreziqe qe kercenojne shendetin dhe mjedisin, do te hartohen dhe rifreskohet Plani i kunderveprimit ndaj ndotjeve me mbetjet qe ruhen/magazinohen perkohesisht ne objekt.
- Komunikimi tek klientet dhe publiku angazhimin mjedisor, duke inkurajuar ata qe ta mbeshtesin ate.
- Fokusohet ne permiresimin e vazhdueshem te performances mjedisore dhe minimizon impaktet dhe demtimet sociale te aktiviteteve duke rishikuar politikat mjedisore ne lidhje me aktivitetet e se ardhmes.

Me hapsirat e krijuara në këtë aktivitet mundesohet nje levizje e mire e mjeteve te transportit te mbetjeve si dhe mjeteve te tjera te cilat i sherbejne aktiviteti.

Sipas tipologjise se mbetjeve dhe klasifikimit te tyre sipas katalogut te mbetjeve, behet e mundur ndarja dhe etiketimi i mbetjeve me qellim magazinimin e tyre. Procesi i etiketimit shoqerohet me ambalazhim te mbetjeve i cili do te jete me konteniere metalike, depozita (fucia) plastike dhe metalike, paleta druri, konteniere plastike, apo thase bigbags 1.3 ton.

Ambienti brenda kapanonit dhe jasht tij eshte i shtruar me beton dhe i pajisur me rrjetin e drenazhimit te ujrave te shiut, duke shmangur mundesine e ndotjes se mjedisit nga levizja e mjeteve, si dhe reduktimin e shkarkimeve ne ajer nga te grimcave te pluhurit si rezultat i levizjes se mjeteve te transportit. Pozicionimi kadastral i zones si dhe infrastruktura e brendshme e objektit eshte e lidhur me infrastrukturen e zones rruga e Polisterolit - Metalurgji dhe me rrugen kryesore nacionale Bradashesh-Peqin apo rrugen Bradashesh - Elbasan. Gjithashtu pergjate gjithë gjatesise se infrastruktures se brendshme eshte ndertuar edhe rrjeti i drenazhimeve te ujrave te shiut.

Infrastruktura prane eshte e mire, me standartet bazike te saj. Gjithashtu objekti nuk perben problem per trafikun perqark zones ne te cilin ndodhet. Aksi i rruges kryesore nga prane tij eshte i shtruar me asfalt si dhe eshte i gjelberuar ne menyre natyrale. Por hyrja ne shesh do te behet nepermjet nje rruge private qe eshte ne perendim te objektit. Ky shesh per nga madhesia e aktivitetit lejon qarkullimin e lire, hyrje – dalje si dhe manovrimet e automjeteve (kamionave, furgonave dhe mjeteve te tjera te transportit) te cilat do ti sherbejne ketij aktiviteti ne kushte te

plota sigurie, si dhe mjetet e zjarrfikeseve ne rastet emergjente te cilat mund te shfaqen ne kete kete aktivitet.

Me qellim ushtrimin e veprimtarise per menaxhimin e mbetjeve, referuar ligjit nr. 57/2025, date 16.10.2025 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve" subjekti ka marre masat e nevojshme per ndertimin e te gjithe infrastruktures inxhinierike me qellim mbrotjen e mjedisit dhe siperfaqes se prones ku do te zhvillohet aktiviteti.

Qellimi i shoqerise eshte:

- a) krijimin e një sistemi të menaxhimit të integruar të mbetjeve për të garantuar mbrojtjen e mjedisit e të shëndetit të njeriut
- b) Perdorimin e burimeve me efikasitet
- c) Krijimin e kushteve per kalimin ne modelin e ekonomise qarkulluese

Objektivat e shoqerise jane:

- a) parandalimi dhe pakesimi i mbetjeve
- b) parandalimi dhe pakesimi i ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i mbetjeve
- c) parandalimit e minimizimit të mbetjeve ose pakësimit të ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve;
- d) përmirësimit të efijencës së përdorimit të tyre;
- e) pakësimit të ndikimeve negative të përgjithshme nga përdorimi i burimeve.

- **Ndërtimi i linjës elektrike**

Në varësi të llojit të pajisjeve dhe fuqisë së instaluar është zgjedhur edhe fuqia e transformatorit të kabinës elektrike. Aktualisht rrejtja e shpërndarjes së energjisë elektrike është në gjëndje mjaft të mire dhe kuadri elektrik është i plotësuar. Siperfaqet e tjera ku ushtrohet veprimtaria per menaxhimin e mbetjeve në të gjitha ambientet e tyre jane pajisur me kaseta të shpërndarjes së energjisë elektrike. Per mbrojtjen nga shkarkimet atmosferike eshte parashikuar nje rrjet tokezimi dhe sisteme tokezimi te vecanta per cdo pajisje.

- **Rruga hyrëse për në objekt dhe rrugët e brëndshme**

Objekti lidhet me rrugen dytesore Polisterolit - Metalurgji dhe me rrugen kryesore nacionale Bradashesh-Peqin dhe Bradashesh - Elbasan. Gjithashtu pergjate gjithe gjatesise se infrastruktures se brendshme eshte ndertuar edhe rrjeti i drenazhimeve te ujrave te shiut.

Infrastruktura prane eshte e mire, me standartet bazike te saj. Gjithashtu objekti nuk perben problem per trafikun perqark zones ne te cilin ndodhet. Aksi i rruges kryesore nga prane tij eshte i shtruar me asfalt si dhe eshte i gjelberuar ne menyre natyrale. Por hyrja ne shesh do te behet nepermjet nje rruge privat qe eshte ne perendim te sheshit. Gjithashtu pergjate gjithe

gjatesise se infrastruktures se brendshme eshte ndertuar edhe rrjeti i drenazhimeve te ujrave te shiut.



Zona ne studim, ka dendesi te ulet te banesave te karakterit banim dhe sherbimi te cilat jane ndertuar ne menyre informale pas viteve 90-te si pasoje e levizjeve demografike te popullsisë, kjo zone eshte njohur si zona industriale e Bashkise Elbasan "Ish Kombinati Metalurgjik Elbasan", ku aktualit gjendet nje numer i ulet i banoreve.

Distanca nga rruga "Elbasan-Peqin" eshte 880 m. Duhet theksuar se ndertimet pas viteve 90-te kan bere qe ne bashkine e Elbasan, te kemi nje keq menaxhim te zonave urbane, duke ndertuar pa kriter dhe jo ne perputhje me planet dhe rregulloret urbanistike te bashkise, gje e cila ka rritur dhe numrin e ndertimeve informale, duke bere fragmentizimin e siperfaqeve te ndertimit.

Shoqeria "POENIA-GROUP" sh.p.k ne cilesine e mbajtesit te lejes mjedisore ekzistuese te tipit B me PN-1872-07-2023 ploteson te gjitha kushtet per menaxhimin aktual te mbetjeve dhe per shtimin e kapaciteteve per menaxhimin e mbetjeve qe kerkon te shtojne ne lejen mjedisore ekzistuese.

Planvendosja e impiantit e paraqitur në ortofoto.



Planvendosje e Veprimtarise

<https://geoportal.aniq.gov.al>
Data e Printimit: 11.02.2023



Planvendosja e impiantit sipas Gaus Kruger 1942 Zone 4



Harta Topografike

<https://geoportal.aniq.gov.al>
Data e Printimit: 11.02.2023



e. PERMBLEDHJA NE GJUHE JO-TEKNIKE

Përmbledhja duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

- **INSTALIMI DHE AKTIVITETET E TIJ;**

Menaxhimi i mbetjeve

- ID 5.5 Magazinim i hekurishteve/skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme
- ID 5.7 Magazinim, trajtim, riparim ose rinovim i mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike (WEEE)
- ID 5.8 Magazinim, rikuperim i hekurishteve/skrapeve të metalit ose çmontimi i mbetjeve nga motorët e makinave
- ID 5.10 a Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme që nuk përmendet më lart
- ID 5.10 b Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart

Sqarim: Instalimet ekzistuese të lejes mjedisore të tipit B me PN-1872-07-2023 funksionojnë vetëm për ruajtjen/magazinimin e perkohshëm të mbetjeve dhe transferim të tyre drejt operatoreve të licencuar, pra nuk do të kemi procese të trajtimit/rikuperimit/riciklimit apo asgjësimit të mbetjeve.

Sqarim: Gjithashtu edhe kodet e reja të mbetjeve për të cilat kërkohej ndryshimi i lejes mjedisore ekzistuese, do të jenë vetëm për ruajtjen/magazinimin e perkohshëm të mbetjeve dhe transferim të tyre drejt operatoreve të licencuar, pra nuk do të kemi procese të trajtimit/rikuperimit/riciklimit apo asgjësimit të mbetjeve.

- **LËNDËT E PARA DHE ATO NDIHMËSE, SUBSTANCAT E TJERA DHE ENERGJIA E PËRDORUR OSE E GJENERUAR NGA INSTALIMI;**

Lëndet e para për vendosjen në funksionim të instalimeve janë karburanti, konteneret, depozita/fucia, thaset bigbags mjetet e transportit, ndërsa lëndet ndihmëse janë energjia dhe uji.

- **BURIMET E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI;**

Shkarkimet kryesore në ajër – Karakteristikat e shkarkimeve (një faqe për çdo pikë shkarkimi)

Nr. Referencës së pikës së shkarkimit	Sh1
Burimi i shkarkimit	Objekti i magazinimit/ruajtjes së mbetjeve
Përshkrimi	Proceset e magazinimit, transferimit të

	mbetjeve
Koordinatat: (GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4)	Pika 1 X: 4551199.03 Y: 4417850.35 Pika 2 X: 4551191.14 Y: 4417854.32
Informacion mbi oxhakun Diametri Lartësia nga toka(m)	
Data e fillimit të shkarkimeve	me miratimin e lejes mjedisore te ndryshuar

Shkarkimet në rrjetin e kanalizimeve (një faqe për çdo pikë të shkarkimeve)

Nr. Ref. i pikës së shkarkimit: (numri i referencës duhet të jetë i njëjtë me numrin e shkruar në hartën e instalimit)	K1
Vendndodhja e pikës së shkarkimit rrjetin e kanalizimeve	Ne brendesi te territorit ku zhvillohet aktiviteti. Ujerat e sanitare
Koordinatat (për efekt të vlerësimit të ndikimit)	X : 4551189.20 Y : 4417841.00
Emri i kompanisë e cila menaxhon sistemin e grumbullimit të ujërave të ndotura	POENIA-GROUP
A është sistemi i kanalizimeve i lidhur me një impiant trajtimi?	Kolektori i ujerave te ndotura te Ish Kombinatit Metalurgjik Elbasan
Emri i mjedisit përfundimtar uJOR pritës të ujërave të ndotura nga rrjeti i kanalizimit (estuar, lumë ose mjedis tjetër uJOR pritës dhe ndikimi në të i cili duhet kontrolluar)	Ujerat sanitare te gjeneruara nga instalimet, dergohen ne kolektorin e perbashket te ujerave te ndotura urbane te zones se Ish Kombinatit Metalurgjik Elbasan

Shkarkimet e zhurmës – Përmbledhje e listës së burimeve të shkarkimit të zhurmës

Burimi i	Nr. Ref. i	Koordinatat	Nr. Ref. i	Presioni	Periudha e
----------	------------	-------------	------------	----------	------------

shkarkimit	pikës së shkarkimit	sipas sistemit GAUS KRUGE: 1942_GK_ZON E_4	pajisjes që gjeneron ndotje aklustike	akustik ¹ (dBA) duke ju referuar distancës	shkarkimit
Brenda objektit	1	X: 4551199.03 Y: 4417850.35		60	Gjate proceseve te funksionimit
jasht objektit	2	X: 4551191.14 Y: 4417854.32		60	Gjate proceseve te funksionimit

- KUSHTET NË VENDNDODHJEN E INSTALIMIT DHE RASTET E NJOHURA HISTORIKE TË NDOTJES;

Zona ku zhvillohet aktiviteti i pajisur me leje mjedisore te tipit B per menaxhimin e mbetjeve te rrezikshme dhe jo te rrezikshme, ndodhet ne Pasuria numer 983, Zona kadastrale 3965, Metalurgjiku, Elbasan.

Objekti dhe siperfaqja truall te marra me qira nga shoqeria jane ekzistuese qe ne kohen e Ish Kombinativ Metalurgjik Elbasan. Zona per ushtrimin e veprimtarise ne fushen e menaxhimit te integruar te mbetjeve eshte perzgjedhur duke qene se eshte nje zone industriale, ne te cilen aktualisht kryhen shume veprimtari te ketij karakteri ne fushen e menaxhimit te mbetjeve. Shtimi i kodeve te mbetjeve te rrezikshme dhe jo te rrezikshme per ruajtje dhe magazinimin e perkohshem te tyre, nuk ndikon ne kushtet aktuale te objektit dhe siperfaqes ku ushtrohet veprimtaria.

• IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS DHE MASAT PER MINIMIZIMIN E TYRE

Mjedisi eshte gjithmone i prekur nga veprimtarite e ndryshme qe ushtrohen ne te, por ndikimi mund te jete i ndryshem, kjo eshte e lidhur ngushte me vete llojin e veprimtarise e cila mund te kete impakt te drejtperdrejte, te terthorte, te rendesishem apo mesatar i pranueshem.

Nje nga objektivat e ketij raporti eshte identifikimi i ndikimeve te mundshme qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky aktivitet ne teresi. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone do te vleresohen ne njerin prej fazave kryesore; faza e operimit, pasi objekti eshte i ndertuar dhe ndikimi ne mjedis do te jete vetem nga funksionimi i paisjeve dhe makinerive te ruajtjes, magazinimit, dhe transferimit te mbetjeve te rrezikshme dhe jo te rrezikshme (te kodeve ekzistuese dhe kodeve te reja qe kerkohen te shtohen). Nuk marrin ne konsiderate fazen pas perfundimit se veprimtarise pasi ky projekt do te vazhdoj te jete i tille dhe pas shume kohesh. Disa prej ndikimeve kryesore qe jane vleresuar si te mundshme jane paraqitur si me poshte.

Efektet e mundshme nga aktiviteti qe ushtrohet do te vleresohen ne menyre te pergjithshme nga ky raport i ndikimeve në mjedis. Megjithate, shume nga efektet e mundshme mund te identifikohe per arsye te eksperiences nga nen-projektet e projektet e meparshme ne kete fushe.

- **Impakti ne mjedis i ketij impianti dhe menaxhimi i tij**

Ne vijim do te paraqesim nje permbledhje te efekteve negative mbi mjedisin te cilat lidhen me operimin e punes ne instalimet e ruajtjes/magazinimit dhe transferimit te mbetjeve te rrezikshme dhe jo te rrezikshme gjate fazes operative sebashku me rekomandimet mbi menaxhimin e tyre.

Ceshtjet e mjedisit te lidhura me fazat e ruajtjes, magazinimit dhe transferimit te mbetjeve ne llogjiken e ciklit te jetes se produktit perfshijne:

- Praktikate qendrueshme: Impakti me i madh mjedisor si ruajtje/magazinim i mbetjeve konsiston ne menaxhimin e lendes se pare duke maksimizuar perdorimin e lendeve te para.
- Praktika te qendrueshme ne menaxhimin e lendes se pare gjate transferimit, ruajtjes, magazinimit dhe perdorimin sa me eficient te saj, duke riperdorur dhe ricikluar ate sasi te mbetjeve qe gjenerohet si mbetje gjate ketij procesi.
